

PLAKU SOFRONI PËR SHPIRTIN DHE JETËN



112.

Tundimeve të djallit në shkretëtirë, Krishti iu kundërvu nëpërmjet hedhjes direkte, duke i bazuar përgjigjet e veta në fjalët e Zotit. Kjo për ne përbën këshillë. Gjithmonë, kur kemi mendim të lig, jemi të detyruar ta hedhim poshtë menjëherë, ta anashkalojmë djallin me të. Kjo, megjithatë, nuk mund të përvetësohet në tjetër mënyrë, vetëm nëpërmjet gritjes shumëvjeçare, nëpërmjet veprimt të bekimit te ne.

113.

Ç'do të thotë ta organizojmë shpëtimin tonë? Me fjalë të tjera, midis gjithçka që vështrojmë në ekzistencën kozmike, ta zgjedhim atë që është e këndshme për Zotin - të zhgërshetohemi prej asaj që është kundër Tij! Atëherë shikojmë se si jeta jonë dalngadalë ndryshon. Megjithatë të jemi të durueshëm, Zoti me siguri mund të na vizitojë që në një moment të na i hapë sytë drejt përjetësisë. Por, në përgjithësi kjo pyetje është shumë e vjetër dhe nuk ka asnjë lidhje me gjithçka që mund të krijojë imagjinata. Lexoni Shën Siluanin! Do të shikoni se gjendja e tij gjithmonë ishte te Zoti! Do ta kuptoni fjalën e tij, që thotë se Njerëzve të Shenjtë nuk ju kalon asnjë sekondë pa lutje.

114.

Si ta bëjmë ndryshimin midis mendimeve që vijnë nga jashtë dhe atyre që lindin në zemrën tonë? Në të shumtën e rasteve, hyrja e energjisë së demonit është kaq suptile, saqë e llogarisim si pjesë tonën. Mësimi që trashëguam prej etërve tanë na ndihmon, por nuk është i mjaftueshëm. Padurueshmërinë dhe shqetësimin që i shkakton ndonjë mendim në zemrën tonë është shenjë se është e dërguar prej armikut. Kjo në përgjithësi ka të bëjë me mendimet fyese. Në qoftë se nuk ndiejmë gëzim dhe kënaqësi prej mendimit që e kemi në shpirtin tonë, do të thotë se ai nuk është prej Zotit, por prej armikut që hyn tek ne!

115.

Nuk është e lehtë të bëjmë ndryshimin midis asaj që lind në shpirtin tonë nën ndikimin e demonit. Deri te kjo gjë dikush arrin shkallë shkallë, nëpërmjet ngritjes, me luftë kundër pasioneve, që ne, fëmijët e Adamit i mbartim në vete. Kështu, dalngadalë, fillojmë të gjykojmë se mendimi i tillë, lëvizja e tillë e shpirtit nuk del prej Zotit, por prej armikut. Gjendja e tillë nuk vjen me mendime, por me ndienjë, parandienjë të drejtpërdrejtë, jashtëzakonisht të hollësishme dhe të aftë për dallim, që gjithmonë është rezultat i punës shumëvjeçare dhe mundimdurese.

116.

Më mirë është të mos ju japim shumë rëndësi mendimeve, por të thellohemi në lutjet, të bisedojmë me Zotin nëpërmjet lutjeve.

117.

Ekzistojnë mënyra të ndryshme me anë të të cilave mund tu kundërvihemi mendimeve të këqija, ta çlirojmë shpirtin tonë prej çdo mendimi të flaktë apo fyese. I pari të cilin e këshillojmë Etërit e kishës është pendimi. I dyti është ta drejtojmë vëmendjen e qenies sonë tek ndonjë gjë tjetër. Kur përqëndrueshmëria drejt të Vërtetës është e përjetshme, armiku nuk është më i interesuar dhe na lëshon.



118.

Në qoftë se pasionet janë të forta dhe në qoftë se ndonjë mendim i tmershëm, i zjarrshëm dhe mëkatar nuk dëshiron të na lëshojë, nuk na ngelet asgjë tjetër veçse të luftojmë duke qarë, për aq kohë të gjatë sa dhe shpirti i keq këmbëngul.

119.

Intelekti ynë është gjithmonë në luftë me intelektin e armikut. Që ta organizojmë jetën tonë është i domosdoshëm qëndrim i fortë për luftë të pandërprerë. Sepse në qoftë se *flemë* i lejojmë armikut që asnjëherë nuk fle, ta mbarojë punën e vet, kështu që gjendemi në rrezik ta humbasim shpëtimin tonë.

120.

Maturia! Me të duhet të fillojë nxitja jonë, kështu që, asgjë në qoftë se është e mundur, nuk ndodh pa Zotin!

121.

Bota që na rrethon sot, jeton në mënyrë më dinamike se dje. Por, sa më tepër ekziston lëvizja në botë, aq më e vështirë është ta ruajmë ndërgjegjen e krishterë. Jemi të sulmuar nga të gjitha anët, nëpërmjet portave të ndjenjave, kështu që është e dallgëzuar sipërfaqja e shpirtit tonë. Nëpër furtunat e epokës sonë korenspondon vigjelenca e përhershme. Së pari këtë kërkoj prej jush: Dëgjoni fjalën e Ungjillit, *vigjiloni* dhe mos luani!

122.

Ta ruajmë këtë me vëmendje, që e mban trupin tonë gjithmonë të gatshëm. Falë kësaj gatishmërie, edhe në gjumë mund ta kemi në mendje, qëllimin e jetës sonë. Lutja mund të futet aq thellë deri tek ajo që psikologët e quajnë nënvetëdijë. Një asket i vërtetë e ruan vetëveten gjithmonë, mandej edhe në gjumë. Në qoftë se papritur shfaqen mendime të këqija, ai ngrihet dhe lutet. Kështu, dalngadalë, vetëdija do ta ndriçojë atë që e bëjmë në jetën tonë të përditshme.

123.

Mos lejoni gjërat tokësore tjua shpërndajnë mendjen. Mblidheni të gjithë vëmendjen tuaj, drejtoheni gjithë energjinë tuaj që jeta juaj t'i përputhet shpirtit dhe urdhërave të Ungjillit.

124.

Ta mbledhim mendjen tonë, përkundrej shpërhapjes së shkaktuar prej botës së jashtme! Asnjëherë, mendja nuk mund të qëndrojë vazhdimisht te Zoti pa nxitje! Që në këtë jetë jemi të detyruar të mësojmë të qëndrojmë me Zotin, që me të vërtetë do të ndodhë me shpirtin tonë pas vdekjes.

125.

Kur flasim për pranishmërinë e Zotit në shpirtin tonë, ajo nuk do të thotë se e shikojmë Zotin, por se Zoti na shikon ne! Ja mendimi i drejtë: Veprojmë para Zotit, i Cili është i pranishëm dhe na vështron.

PLAKU SOFRONI PËR SHPIRTIN DHE JETËN

126.

Në lidhje me pyetjen për ëndërrat, nuk mund të them asgjë më tepër se Shën Joan Lestviçnik. Sipas Atëve të Kishës qëndrimi më i përshtatshëm është të mos ju besojmë. Që të na bindë të besojmë në vizionet tona, armiku me të vërtetë mund të na japë ëndërra, të cilat më pas realizohen në jetën e përditshme. Domethënë, duhet të jemi shumë *të kujdesshëm!* Mjafton që vetëm njëherë të na ndodhë të besojmë, dhe ja iluzioni i shoqëruar me të gjitha rreziqet e tij! Ne e kemi Fjalën e Krishtit dhe të Apostujve. Ajo është e mjaftueshme për ne!

127.

Është shumë e rëndësishme të synojmë asnjëherë të mos fitojmë shenja të dukshme të bekimit të Perëndisë, siç është për shembull dhurata e çudibërjes.

128.

Ta jetojmë Krishtin vetë dhe për vetveten, në largësi prej të tjerëve, ajo për jetën e krishterë do të thotë të jetohet mosmjaftueshmëria e qenies njerëzore. Përkundrajt kësaj, kur dy, tre, katër apo më shumë mblidhen për të njëjtin qëllim, fuqia e çdonjërit prej tyre rritet në pambarim. Bibla thotë: *Vështirë është për njërin!* Përkundrajt kësaj, dy mund të jenë të patundshëm.

129.

Ajo që është e rëndësishme për një vëllazëri manastiri është që të gjithë të kemi vështrim të njëjtë të punëve, që ta organizojmë me ngushëllim, shpëtimin tonë personal, shpëtimin e atyre që janë afër nesh, dhe të të gjithë atyre që vijnë tek ne!

130.

Teologjia akademike nuk është e mjaftueshme për shpëtim! Lexoni etërit asketë! Aty do ta mësoni teknologjinë e vërtetë, mendimin e mendjes dhe zemrës së Zotit.



превод на албански:
Јордана Шемко

Plaku Sofroni
PËR SHPIRTIN DHE JETËN
Biblioteka FJALA PREJ VODOÇËS
EDICIONI:
BANORËT E MALIT TË SHENJTË

LIBRI 2

Titulli në origjinal
PLAKU SOFRONIJ (SAHAROV)
PËR JETËN DHE SHPIRTIN

Përktheu nga greqishtja
Peshkopi i Strumicës Zoti NAUM

KISHA ORTHODHOKSE MAQEDONASE
EPARKIASTRUMICË